



Pranimi / Dohetuat Prilbena/Prodato Received/Delivered	18.08.2022	2	viti grad year
Organ /Ihësia Organ /Ishësia Org /Ishësia	Ri /Prof Ri /Prof Prof No	Shfota /a Prilog Appendix	Sasra Kohësira Quantity
SKM/SHAK	4790/2022		15



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.599/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.599/2022 të datës 06.07.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë

në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 17.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.599/2022 e datës 06.07.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. Obligohet Kryetari i Komunës së Prishtinës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, ankuesit ti lëshoj plotësim-ndryshimin e Akt emërimit në pajtim me klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil në Komunën e Prishtinës, Rregulloren për Organizimin, Kompetencat, Përgjegjësitë dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës së Administratës Komunale të Komunës së Prishtinës, duke marrë për bazë kualifikimin, përvojën dhe përshkrimin e vendit të punës së ankuesit.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesi sipas Akt emërimit me numër 01-112-540 të datës 12.03.2013, ka mbajtur pozitën e punës "Zyrtar i Lartë", në Drejtorinë për ekonomi dhe zhvillim- Sektorin e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural në Komunën e Prishtinës. Me datën 01.02.2017 Kryetari i Komunës së Prishtinës, ka nxjerrë Akt emërimin me numër 01nr.112-540, sipas të cilit e ka sistematizuar ankuesin në pozitën "Zyrtar për blegtori, bletari dhe veterinari" në Drejtorinë e bujqësisë.

I pakënaqur me Akt emërimin 01nr.112-540, ankuesi me datën 28.04.2017 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Prishtinës me datën 11.05.2017 ka nxjerrë Vendimin me numër 01-070/01-0099481/17, sipas të cilit e ka refuzuar ankesën e ankuesit.

Kundër Vendimit me numër 01-070/01-0099481/17 të datës 11.05.2017, ankuesi me datën 24.05.2017 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa ky i fundit me datën 20.07.2017 ka nxjerrë Vendimin 02/269/2017 sipas të cilit e ka shfuqizuar Vendimin 01-070/01-0099481/17 e datës 11.05.2017 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Prishtinës si dhe ka shfuqizuar po ashtu edhe Akt emërimin e ankuesit me numër 01nr.112-540 të datës 01.02.2017, duke e obliguar Kryetarin e Komunës së Prishtinës, që të bëjë rishqyrtimin e sistemimit të ankuesit nga pozita Zyrtar i larte ne Sektorin e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural në Drejtorinë për Ekonomi dhe Zhvillim ne pozitën Zyrtar për blegtori, bletari dhe veterinari në Drejtorinë e bujqësisë të Komunës së Prishtinës.

I pakënaqur me moszbatimin e vendimit të Këshillit, me datën 19.05.2022 ka parashtruar kërkesën me numër 14-117/01-110505/22 tek Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prishtinës lidhur me njohjen e koeficientit për pozitën Zyrtar i lartë ne Sektorin e bujqësisë, ndërsa kjo e fundit me datën 20.06.2022, ka njoftuar ankuesin se Kryetari i Komunës së Prishtinës pasi ka bërë riorganizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës për të gjithë nëpunësit civil dhe në bazë të Vendimit 14-035/01-45399/18 të datës 23.02.2018 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, ka lënë në fuqi te gjitha akt emërimet për nëpunësit civil.

Ankuesi pas marrjes se njoftimit nga ana e Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, me datën 06.07.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 3933/2022 të në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me ndryshimin e akt emërimit nga pozita zyrtar i lartë në pozitën si zyrtar në Komunën e Prishtinës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 18.07.2022, ka proceduar kërkesën me numër të protokollit 4178/2022 për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa me datën 01.08.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga ky institucion së bashku me provat e lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot:3933/2022 të datës 06.07.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 20.06.2022 nga Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës; Formularin për kërkesë apo ankesë të datës 19.05.2022 nga ankuesi; Akt emërimit e ankuesit me numër 01nr.112-540 të datës 01.02.2017; Vendimin A 02/269/2017 të datës 20.07.2017 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimit e ankuesit me numër 01-112-540 të datës 12.03.2013; Vendimin me numër 01-070/01-0099481/17 të datës 11.05.2017 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 18.07.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në kërkesë të datës 01.08.2022 nga Komuna e Prishtinës me provat e bashkangjitura në lëndë; Përshkrimin e detyrave të punës për titullin e vendit të punës zyrtar për blegtori, bletari dhe veterinarin të datës; Vendimin me numër 14-035/01-45399/18 të datës 23.02.2018 nga Kryetari i Komunës së Prishtinës; Listën e pagave për muajt maj, qershor dhe korrik të viti 2022 për ankuesin; Akt emërimit me numër 01nr.112-257 të datës 01.02.2017 për nëpunësen M.T; Akt emërimit me numër 01nr.112-1069/1 të datës 02.10.2019 për nëpunësen M.B-P; Akt emërimit me numër 01; Kartelën e nëpunësit të datës 15.08.2022 për nëpunësen M.B-P si dhe Kartelën e nëpunësit të datës 15.08.2022 për nëpunësen M.T.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi së ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ndërlidhur me ankesën e ankuesit i'u është referuar Vendimit A/02/269/2017 të datës 20.07.2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, sipas të cilit e ka shfuqizuar Akt emërimit e ankuesit me numër 01nr.112-540 të datës 01.02.2017 për caktimin e ankuesit në pozitën zi "Zyrtar për blegtori, bletari dhe veterinarin" si dhe e ka obliguar Kryetarin e Komunës së Prishtinës, që të bëjë rishqyrtimin e sistemimit të ankuesit nga pozita si "Zyrtar i lartë" në Sektorin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Drejtorinë për Ekonomi dhe Zhvillim në pozitën "Zyrtar për Blegtori, Bletari dhe Veterinari" në Sektorin për Bujqësi në Drejtorinë e Bujqësisë në Komunën e Prishtinës, me arsyetimin se sipas Vendimit me numër 01 Nr.031-13761 të datës 19.01.2016 për Organizimin, Kompetencat, Përgjegjësitë dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës së Administratës Komunale, nuk është përcaktuar sistematizimi i vendeve të punës të nëpunësve civil në administratën komunale të Prishtinës, por është paraparë vetëm organizimi i strukturave organizative, respektivisht Drejtorive dhe Sektorëve në kuadër të administratës, andaj sistemimi nga një pozitë tjetër i ankuesit mbi bazën juridike të këtij vendimi është e paqartë, meqenëse nuk kemi pasur një pasqyrë reale se mbi bazën juridike të këtij vendimi është paraparë që pozita të cilën e ka mbajtur ankuesi sipas Akt emërimit me Nr.01-112-540 të datës 12.03.2013 është shuar apo që pozita në të cilën është sistemuar ankuesi sipas Akt emërimit me numër 01nr.112-540 të datës 01.02.2017 është pozitë e re e aprovuar. Ndërlidhur me këtë çështje, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk ka poseduar dëshmi se lidhur me atë se është zbatuar vendimi i tij në

lidhje me sistemimin e pozitës së ankuesit, meqenëse e ka shfuqizuar Akt emërimin me numër 01nr.112-540 të datës 01.02.2017.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka analizuar Vendimin me numër 14-035/01-45399/18 të datës 23.02.2018, i nxjerrë nga Kryetari i Komunës së Prishtinës dhe ka konstatuar se i njëjti me këtë vendim ka lënë në fuqi të gjitha akt emërimet e nxjerra në përputhje me Vendimin për Organizimin, Kompetencat, Përgjegjësitë dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të datës 01-031-13761 të datës 19.01.2016, mirëpo që për rastin e ankuesit ndërlidhur me këtë çështje Këshilli ka konstatuar se Vendimi me numër 01-031-13761 i datës 19.01.2016, i Kryetarit të Komunës së Prishtinës është nxjerrë në kundërshtim me legjislacionin e vjetër ngase me të njëjtin nuk është përcaktuar sistematizimi i vendeve të punës por është paraparë vetëm organizimi i strukturave organizative, respektivisht drejtorive dhe sektorëve ne kuadër te administratës komunale ne Prishtine, gjë që edhe pas kësaj shtate juridike nga ana e Kryetarit të Komunës së Prishtinës nuk janë ndërmarrë veprime ligjore lidhur me sistemimin e pozitës së ankuesit.

Andaj pas konstatimit të gjendjes faktike lidhur me ankesën e ankuesit, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave e Obligon Kryetarin e Komunës së Prishtinës, që në pajtim me legjislacionin në fuqi të nxjerrë plotësim-ndryshimin e Akt emërimin për ankuesin si dhe ta sistemoj të njëjtin duke marrë për bazë kualifikimin, përvojën dhe përshkrimin e vendit të punës, meqenëse sipas Vendimit A02/269/2017 të datës 20.07.2017 është shfuqizuar Akt emërimi me numër 01nr.112-540 të datës 01.02.2017 i ankuesit për pozitën "Zyrtar për blegtori, bletari dhe veterinar", ne kuadër te Drejtorisë se bujqësisë te Komunës se Prishtinës.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 ë Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.599/2022, datë 17.08.2022.

Ardita Perçuku-Shyti


Zyrtare e larte për bashkëpunim profesional

Arben MEHMETI


Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- ❖ Ankuesit.
- ❖ Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës dhe
- ❖ Arkivot të KPMSHCK- së.

